



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSA" VLORE

VENDIM

Nr. 27, Dt. 06.08.2007

Per miratim ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimit ujqor, lumit te "Bences", per prodhim te energjise elektrike, subjektit "Kronos Konstruksion" sh.p.k. Tirane.


Ne zbatim te Ligjit Nr.8093 Dt.21/03/1996 "Per Rezervat Ujqore", te ligjit nr. 9663, dt.18.12.2006 "Per koncesionet", kreu IV, te Vendimit te K.M-se nr. 27, dt. 19.01.2007, "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve", kreu II, te vendimit te K.K.U-se, nr.3, dt. 19.07.2002 "Per miratimin e rregullores te Sekretariatit Teknik, te K.K.U-se, te K.B.U dhe A.U. -it", si dhe udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E, K.B.U "Vjose":

VENDOSI:

1. Miratimin ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimit ujqor, lumit te "Bences", (dege e lumit Vjose), ne afersi te vendbashkimit te perroit te Gurres me lumin e Bences, (aty ku merr uje kanali ujites Bence - Veliqot) per prodhim te energjise elektrike, subjektit "Kronos Konstruksion" sh.p.k. Tirane. Me koordinata:
 $X = 44 \ 11 \ 250$ $Y = 44 \ 58 \ 250$ $Z = 265 \text{ m}$
2. Sasia e ujit qe jepet ne perdorim, per prodhim te energjise elektrike, do te jete $2 \text{ m}^3/\text{sek}$.
3. Periudha e shfrytezimit te ujit, gjate gjithë vitit, perjashto periudhen nga 01.06. deri me 30.09, ku sasise te mesiperme do ti zbritet $0.5 \text{ m}^3/\text{sek}$, qe do te perdoret per ujitje.
4. Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore, per zbatimin e ketij vendimi.
5. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"

Vezir METAJ



KRYETARE E K.B.U-se

Dorothe KONOMI

